



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 95/1 Prot.

Tiranë, më 13 / 01 / 2021

V E N D I M

Nr. 06, Datë 13 / 01 / 2021

Mbështetur në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 118, datë 15.10.2020, e A.M kundër Bashkisë Mallakastër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: *“Që nga data 16.08.2011 ka qenë punonjës pranë Bashkisë Mallakastër në pozicionin si specialist murator. Në datë 23.09.2019 ka marrë lejen vjetore dhe ka kërkuar dhe 2 muaj leje pa të drejtë page nga Bashkia Mallakastër për tu vizituar jashtë vendit, për arsye se prej vitesh vuan nga një sëmundje kronike. Vizita shëndetësore i ka zgjatur më shumë se sa kishte parashikuar dhe për këtë ka njoftuar në telefon se do kthehej pas 15 ditësh. Kur është kthyer nga jashtë, në datë 02.12.2019 i është komunikuar pushimi nga puna dhe në datë 04.12.2019 i kanë ndërprerë marrëdhëniet financiare. Pas kësaj, është paraqitur tek zyra e sigurimeve shoqërore për të përfituar 1 vit pagesë papunësie. Ka përfituar pagesë papunësie për një periudhë dy mujore pastaj i është ndërprerë*

¹ Referuar informacionit datë 21.09.2020 të Spitalit Amavita, ankuesi prej një periudhë 10 vjeçare trajtohet për, dg cefale dhe humbje të ekuilibrit dhe hipertensionit arterial.

duke i kërkuar që të kthejë shumën e përfituar me arsyen se nuk ishin paguar sigurimet shoqërore gjatë kohës që ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Mallakastër”.

Ankuesi, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12/1/c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:.....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pas analizimit paraprak të ankesës Nr. 118, datë 15.10.2020, të A.M u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1220/4, datë 26.10.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Mallakastër për ankesën e bërë nga A.M si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të emërimit të A.M në Bashkinë Mallakastër dhe kopje të kontratës së punës.
 - Kopje të procedurës së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, si dhe parashtime lidhur me shkakun e zgjidhjes së kontratës me A.M (fakte dhe prova).
 - Informacion dhe kopje të procedurës së emërimit të zëvendësueses/it, nëse ka.
 - Informacion për punonjës të tjerë që i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye të mosparaqitjes në punë, që nga data 01.01.2019 deri në datë 27.11.2019.
 - Kopje të raporteve mjekësore të dorëzuara nga A.M në bashki për periudhën e viteve 2018-2019.
 - Kopje të procedurës së dhënies së lejes vjetore dhe lejes pa të drejtë page A.M për periudhën shtator-nëntor 2019 dhe të periudhave në përpara, nëse ka.
 - Informacion nëse ka punonjës të tjerë të bashkisë që kanë kërkuar dhe kanë përfituar leje pa të drejtë page për arsye të ndryshme, gjatë viteve të fundit.
 - Argumentet e bashkisë për mospagesën e sigurimeve shoqërore për punonjësin A.M dhe mospërfitimin e pagesës së papunësisë.
 - Kopje të vlerësimit të punës për vitin 2017, 2018 dhe 6-mujorin e I-2019 dhe të masave disiplinore për punonjësin A.M.
 - Kopje të Rregullores së Brendëshme të Bashkisë.
 - Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, një kopje të kërkesë padisë, të prapësimeve të bashkisë dhe vendimit të gjykatës, nëse ka.
- Me shkresën nr. 1220/3, datë 26.10.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar ankuesit të paraqesë fakte dhe prova për të vërtetuar gjendjen shëndetësore dhe dokumentacion plotësues lidhur me pretendimet e tij.

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme, ankuesi me shkresat datë 05.11.2020 dhe 03.12.2020 ka dërguar dokumentacionin plotësues të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Me shkresën nr. 2425/1, datë 09.11.2020, Bashkia Mallakastër, në mes të tjerash informoi se: *“Ankuesi A.M ka filluar marrëdhëniet e punës në Bashkinë Mallakastër në datë 16.08.2011, në pozicionin e punës si murator. Marrëdhëniet e punës me A.M kanë zgjatur deri më datë 03.12.2019 për shkak të mosparaqitjes në punë për më shumë se 5 ditë rresht pa shkaqe të justifikuara ligjërish”.*

- Me shkresën nr. 1654, datë 26.11.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion shtesë nga Bashkia Mallakastër si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Shpjegime, lidhur me pretendimet e ankuesit për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore.
 - Argumentet e bashkisë për mospagesën e sigurimeve shoqërore për punonjës in A.M dhe mospërfitimin e pagesës së papunësisë.
 - Kopje të listëpagesës së pagave të punonjësve të Drejtorisë së Infrastrukturës, Shërbimeve Publike dhe Transportit, për muajt, nëntor dhe dhjetor 2019.
 - Kopje të raporteve mjekësore të dorëzuara nga A.M në bashki për periudhën e viteve 2018-2019.

Me shkresën nr. 2425/3, datë 11.12.2020, Bashkia Mallakastër, në mes të tjerash informoi se: *“Ankuesi A.M ka kryer lejen vjetore për vitin 2019 nga data 17.09.2019 deri në datë 14.10.2019. Pas përfundimit të lejes vjetore, ankuesi në datë 14.10.2019 ka paraqitur kërkesë për t’u trajtuar me leje pa të drejtë page, e cila është konfirmuar nga institucioni me shkresën nr. 418, datë 18.10.2019. Bazuar në nenin 96/2 të Kodit të Punës, theksohet se leja pa të drejtë page është e papagueshme, pra del qartë se nuk janë paguar sigurimet shoqërore për këtë periudhë. Bashkia informon se nuk disponon kopje të raporteve mjekësore të A.M për arsye se ato dorëzohen në institucionin e Sigurimeve Shoqërore dhe paguhen nga ata. Gjithashtu, Bashkia Mallakastër informoi se nuk është institucioni kompetent lidhur me mospërfitimin e pagesës së papunësisë së A.M, pasi përfitimi i pagesës së papunësisë trajtohet nga Zyra Vendore e Punësimit Gjirokastër”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankuesit për trajtimin diskriminues në procedurën e ndjekur për largimin e tij nga puna, për shkak të gjendjes shëndetësore.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe në analizë të sa më sipër, rezultoi se:

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune të pandërprera me Bashkinë Mallakastër, me detyrën, punëtor shërbimi (usta) në Drejtorinë e Infrastrukturës, Shërbimeve Publike dhe Transportit, që nga data 16.08.2011³.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 345, datë 19.09.2019, Bashkia Mallakastër, në mes të tjerash ka pranuar dhe kërkesën e A.M për kryerjen e pushimeve vjetore nga data 17.09.2019 deri në datë 14.10.2019.

Me kërkesën datë 14.10.2019, A.M ka kërkuar nga Bashkia Mallakastër, që të marrë 1 (një) muaj leje pa të drejtë page për arsye shëndetësore. Me Urdhrin e Brendshëm nr. 418, datë 18.10.2019, Bashkia Mallakastër, në mes të tjerash ka pranuar dhe kërkesën e A.M për kryerjen e lejes pa të drejtë page nga data 15.10.2019 deri në datë 11.11.2019.

Në përfundim të lejes pa të drejtë page, ankuesi ka deklaruar se ka lajmëruar me telefon institucionin se nuk mund të kthehej në kohë pasi i kanë zgjatur procedurat e dokumenteve shëndetësore, kërkesë e cila nuk i është marrë parasysh nga punëdhënësi.

Me shkresën datë 22.11.2019, Drejtori dhe P/Sektorit të Drejtorisë së Infrastrukturës kanë informuar Sektorin e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mallakastër, se A.M nuk është paraqitur në punë nga data 18.11.2019 deri në datë 22.11.2019.

Me shkresën nr. 2883, datë 26.11.2019, “Autorizim”, Kryetari i Bashkisë Mallakastër ka autorizuar komisionin që të kryejë të gjitha procedurat sipas nenit 144 të Kodit të Punës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës mes bashkisë dhe A.M.

Me shkresën nr. 2883/1, datë 27.11.2019, “Njoftim për zhvillimin e takimit për fillimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës”, është njoftuar ankuesi, me anë të shërbimit postar, për zhvillimin e takimit me punëdhënësin, në datë 02.12.2019.

Në datë 02.12.2019 nga ana e Komisionit, është mbajtur Procesverbali nr. 2883/2, ku është përshkruar shkaku i zgjidhjes së marrëdhënies së punës me A.M, dhe në të cilin evidentohet se ankuesi nuk ka pasur mundësinë për t’u shprehur për mungesat në punë, pasi nuk është paraqitur.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 499, datë 03.12.2019 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe financiare të A.M”, është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës të A.M, për shkak

³ Referuar Librezës së Punës së ankuesit.

të mosparaqitjes në punë për më shumë se 5 (pesë) ditë me rradhë dhe mungesës së argumenteve e justifikimeve me shkrim ose në format e tjera të kërkuara nga ligji (raport mjekësor).

Neni 37, i Kodit të Punës përcakton shprehimisht se: *“Masat disiplinore parashikohen kryesisht në kontratën kolektive të punës. Në çdo rast kontrata individuale duhet t’i referohet akteve përkatëse, lidhur me masat disiplinore. Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova, brenda një afati të arsyeshëm”.*

Përsa i takon procedurës së ndjekur lidhur me dhënien e masës disiplinore të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të ankuesit, Komisioneri gjykon se, nga ana e Bashkisë Mallakastër nuk u sollën prova dhe dokumentacion që të mund të provonin apo përligjinin faktin se punëdhënësi (Bashkia Mallakastër), kishte ndjekur dhe zbatuar procedurën e rregullt ligjore lidhur me njoftimin e masës, të drejtën e ankuesit për t’u dëgjuar dhe mbrojtur efektivisht.

Komisioneri vlerëson se, dhënia e masave disiplinore është pjesë e mjeteve ligjore për mbrojtjen e punëdhënësit, në rastet kur punëmarrësi nuk i respekton rregullat dhe normat kontraktore dhe ligjore. Masat disiplinore duhet të jepen duke respektuar parimin e proporcionalitetit, që parashikon se për një shkelje të lehtë, duhet të jepet masë disiplinore e lehtë e më tej duke u përshkallëzuar. Masa disiplinore duhet të dokumentohet, të materializohet dhe t’i bëhet me dije punëmarrësit në kohën kur jepet, sepse ai ka të drejtën e ankimit ndaj masës.

Ankuesi nuk ka marrë dijeni për njoftimin nr. 2883/1, datë 27.11.2019, *“Njoftim për zhvillimin e takimit për fillimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës”*, pasi ka qenë në kushte të pamundësisë objektive, për të marrë dijeni për takimin pasi ka qenë jashtë shtetit⁴ dhe nuk kishte mundësi që të ishte prezent në takim. Gjithashtu, ankuesi ka deklaruar se ka njoftuar me telefon institucionin se do të vonohej për arsye të zgjatjes së procedurës së bërjes së dokumenteve shëndetësorë.

Në dispozitat e Kodit të Punës parashikohet se punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën e punës pa dhënë më parë arsyet me shkrim për zgjidhjen e kontratës. Në momentin që punëdhënësi vendos të ndërpresë marrëdhënien e punësimit me punëmarrësit ai duhet t’a bëjë atë konform një procedure të përcaktuar dhe të parashikuar nga neni 144, të Kodit të Punës, ku parashikohet se: *“1. Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedojë me të. 2. Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t’u marrë dhe i jep atij mundësi për t’u shprehur. 3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Në njoftimin me shkrim, punëdhënësi përcakton arsyet e zgjidhjes së kontratës, të cilat lidhen*

⁴ Referuar pasaportës dhe deklaramit të bërë në telefon, datë 25.11.2020 të A.M, vërtetohet se ankuesi është kthyer në Shqipëri në datë 07.12.2019.

me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operationale të ndërmarrjes. 4. Shfuqizuar. 5. Punëdhënësi, i cili nuk respekton procedurën e përcaktuar në këtë nen, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim të barabartë me pagën e dy muajve, që i shtohet dëmshpërblimeve të tjera të mundshme. 5/1. I takon punëdhënësit të provojë respektimin e procedurës së përcaktuar në këtë nen. 6. Kjo procedurë nuk zbatohet në rastet e pushimeve kolektive nga puna, por arsyet me shkrim për zgjidhjen e kontratës do t'i jepen punëmarrësit, sipas afateve të përcaktuara në pikën 5, të nenit 148, të këtij Kodi”

Bashkia Mallakastër ka njoftuar ankuesin për zhvillimin e bisedimeve paraprake (shkresa nr. 2883/1, datë 27.11.2019), por nuk arriti të provojë se ka realizuar takim paraprak me ankuesin ku t'i ketë parashtruar këtij të fundit shkaqet për të cilat ka vendosur të ndërpresë marrëdhënien e punës si dhe për t'i dhënë mundësinë këtij të fundit që të dëgjohet dhe të mbrojë interesat e tij. Dispozita e mësipërme, në pikën 5/1 përcakton qartë se është detyrim i punëdhënësit që të provojë se ka respektuar procedurën e parashikuar në nenin 144, të Kodit të Punës.

Në analizë të informacionit dhe legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës së A.M, nuk konstatoi se ankuesit i është garantuar e drejta për t'u informuar, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Për më tepër, Bashkia Mallakastër ishte në dijeni se A.M kishte kërkuar leje pa të drejtë page për arsye shëndetësore dhe që ankuesi kishte 8 vjet që ishte punonjës i bashkisë dhe nuk kishte pasur masa disiplinore për arsye të mungesave në punë.

Bashkia Mallakastër nuk dha një shpjegim objektiv dhe të justifikuar lidhur me faktin nëse ankuesi kishte marrë dijeni për fillimin dhe për datën e takimit që do zhvillohej mes palëve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punësimit.

Lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, Komisioneri vlerëson se nga ana e Bashkisë Mallakastër është shkelur e drejta e ankuesit për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur ndaj masës së dhënë, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht i njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e Bashkisë.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të paligjshëm dhe të padrejtë, nga ana e Bashkisë Mallakastër, pasi largimi i tij nga puna është bërë në shkelje të plotë të procedurës të parashikuara nga Kodi i Punës.

B. Lidhur me mospërfitim të pagesës së papunësisë të ankuesit.

Në nenin 53/1 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Personat e sigurve përfitojnë të ardhura papunësie, në rast se: a) kanë kontribuar në sigurimin shoqëror jo më pak se 12 muaj për çdo rast përfitimi dhe b) janë vërtetuar nga zyra përkatëse e punës se: - janë punëkërkues të papunë, të gatshëm të punësohen kur iu ofrohet një punë e paguar, e përshtatshme.....”.

Në pikën 1 të Udhëzimit nr. 17, datë 14.05.2018 “Për zbatimin e VKM-së nr. 161, datë 21.03.2018 “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”” parashikohet se: “Në zbatim të pikës 2 të Vendimit, përfitojnë pagesën e së ardhurës nga papunësia personat, të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme: a) Të kenë kontribuar në sigurimet shoqërore për një periudhë të paktën 12 mujore gjithsej, për çdo rast përfitimi; b) Të jenë regjistruar si punëkërkuar të papunë pranë zyrës përkatëse të punësimit; c) Të kenë paraqitur me shkrim kërkesën për aplikim dhe të kenë plotësuar dokumentacionin përkatës, brenda 60 ditëve nga data e shkëputjes së marrëdhënieve financiare me punëdhënësin. Jastë këtij afati përfituesit e humbasin të drejtën e pagesës së të ardhurës nga papunësia, me përjashtim të rasteve kur janë të paafte për punë e vërtetuar me raport mjekësor ose dokumenta shoqëruese, që kanë qenë të shtruar në spital (fletë hyrje dhe fletë dalje nga spitali)”.

Lidhur me mospërfitimin e pagesës së papunësisë, Zyra Vendore e Punësimit Mallakastër me shkresë nr. 193, datë 01.12.2020, “Vërtetim”, ka informuar A.M se: “A.M është rregjistruar si punëkërkuar i papunë me datë 30.01.2020 dhe ka bërë kërkesë për pagesë papunësie, pasi ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Mallakastër, sipas librezës së punës që ka paraqitur ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me datë 04.12.2019. Duke qenë limitet kohore (për 4 ditë mbaronte afati 60 ditor) të plotësimit të dokumenteve, si dhe dorëzimi në kohë i borderove për likuidim, specialistja e pagesës e ka parë të arsyeshme që ta pranojë në pagesë papunësie, duke i hedhur dy paga për muajin nëntor dhe dhjetor 2019. Pas verifikimeve të mëtejshme u vërejt se A.M nuk kishte sigurime për muajt, nëntor dhe dhjetor duke tejkalluar afatin 60 ditor. Në këto kushte A.M i është arkëtuar shuma prej 24313 lekë që kishte përfituar padrejtësisht që prej datës 05 dhjetor deri me 31.01.2020”.

Në analizë të informacionit dhe legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri vlerëson se ankuesi ka qenë në dijeni të mospërfitimit të pagës dhe të mospagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga ana e punëdhënësit që në momentin kur ka bërë kërkesën datë 14.10.2019 për të marrë një muaj leje pa të drejtë page dhe për periudhën në vijim duke mos u paraqitur në punë.

Nga analizimi i shkresës së sipërpërmendur, KMD konstatoi se ankuesi është rregjistruar si punëkërkuar i papunë dhe ka bërë kërkesë për pagesë papunësie, në datë 30.01.2020, pra rreth 90 ditë pasi nuk ishin paguar kontributet për sigurimet shoqërore nga ana e punëdhënësit, pra në tejkallim të afatit 60 ditor të përcaktuar në Udhëzimin nr. 17, datë 14.05.2018 “Për zbatimin e VKM-së nr. 161, datë 21.03.2018 “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia””.

Në referencë të nenit 7, të LMD, Komisioneri gjykon se për sa i përket mospërfitimit të pagesës së papunësisë, A.M nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Mallakastër. Në mungesë të këtij trajtimi nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

C. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁵, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për cilindo nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Në ankesën e subjektit ankues, pretendohet diskriminim, për shkak të “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Bashkisë Mallakastër.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën nr. 1220/3, datë 26.10.2020, ka kërkuar ankuesit të paraqesë fakte dhe prova për të vërtetuar gjendjen shëndetësore, pasi në dokumentacionin e dërguar në plotësim të formularit të ankesës, për të vërtetuar gjendjen e tij shëndetësore, ankuesi kishte dërguar një informacion të Spitalit Amavita, datë 21.09.2020, në të cilën përshkruhej se A.M prej një periudhë 10 vjeçare trajtohej për, dg cefale dhe humbje të ekuilibrit dhe hipertensionit arterial.

Ankuesi në përgjigje të kërkesës së Komisionerit për të vërtetuar gjendjen e tij shëndetësore, me shkresën datë 05.11.2020 ka dërguar disa receta dhe përgjigje të analizave mjekësore të bëra gjatë viteve 2018-2019, por nuk dërgoi asnjë dokumentacion, si psh: raport mjekësor, fletë rekomandimi për KEMP, fletë shtrimi në spital, vizita mjekësore të realizuara në Gjermani, etj, në mënyrë që të dokumentonte gjendjen e tij shëndetësore.

Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të A.M do të ishte i domosdoshëm, për të provuar që arsyeja e mungesës së tij në vendin e punës, ka qenë gjendja e tij shëndetësore. Për sa kohë që ankuesi, nuk arriti të provojë, si pranë Komisionerit ashtu dhe pranë punëdhënësit, gjendjen e tij shëndetësore, atëherë mungesa e këtij dokumentacioni, i jep shkak të ligjshëm Bashkisë Mallakastër për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të mungesave në punë.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se A.M i është nënshtruar një qëndrimi të paligjshëm e të padrejtë nga ana e Bashkisë Mallakastër.

Nga ana tjetër, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk arriti të provojë dhe dokumentojë shkakun e mbrojtur të pretenduar pretenduar prej tij.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht konstatimit të faktit se subjekti ankues i është nënshtruar trajtimit të padrejtë e të paligjshëm nga ana e Bashkisë

⁵ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”

Mallakastër, lidhur me të drejtën e tij për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, nuk u arrit të provohej se largimi i tij nga puna ishte motivuar për shkak të “gjendjes shëndetësore” të ankuesit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7/1, nenin 12/1/c, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetasit A.M nga ana e Bashkisë Mallakastër, për shkak të gjendjes shëndetësore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA